

Kosovarja kapet në Aeroportin e Prishtinës me armë zjarri në bagazh



14/10/2025 16:52

f

t

l

Policia e Kosovës ka njoftuar se në Aeroportin e Prishtinës, në bagazhin e një gruaje është gjetur një armë zjarri.

Në njoftimin e policisë thuhet se arma është gjetur në prezencën e të dyshuarës.


“Me datën 14.10.2025 në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës (në shkuarje) gjatë kontrollit tek gjërat personale si dhe në bagazhin e pasagjeres femër kosovare, nga zyrtarët e X-Ray-it është detektuar një armë zjarri”.

“Policia e Kosovës kësaj informate i është përgjigjur menjëherë në vendngjarje, me ç’rast pas hapjes së bagazhit në prezencën e të dyshuarës është gjetur arma e zjarrit. Lidhur me rastin ndaj të dyshuarës me vendim të prokurorit kujdestar është iniciuar rast për veprën penale “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armës”, thuhet tutje në njoftim.

LAJME TË FUNDIT

- 

Pamje nga automjeti që ra në Ujman, të...
- 

Në prag të dimrit, shkon në “qiell” çmimi i druve në Prishtinë
- 

Zbardhet dinamika e vrasjes së gjyqtarit Kalaja
- 

Kosova dhe SHBA diskutojnë për prokurime të reja...

Artikuj të ngjashëm



October 14, 2025

Pamje nga automjeti që ra në Ujman, të rinjtë shkuan për...

Other Links

- Fact-Checking Policy

Ethics Policy

Corrections Policy

Ownership & Funding Information

Editorial Team Information